



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 51

Prishtinë, më 12.06.2012, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Anton Quni, Ganimete Musliu

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit të mbajtura, më 04.05.2012 dhe 21.05.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve së Komisionit, të mbajtura, më 04.05.2012 dhe 21.05.2012.

Kryetari i Komisionit- A ka vërejtje për procesverbalin e datës 04.05.2012 dhe 21.05.2012?

Meqenëse nuk ka vërejtje, i konsiderojmë të miratuar procesverbalet e mbledhjes së mbajtur më 04.05.2012 dhe 21.05.2012.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim.

Kryetari i Komisionit- Për të vazhduar procedurat adekuate caktojmë një grup punues i cili i sjell Komisionit propozimin, pastaj Komisioni bënë aprovimin e projektligjit. Për këtë qëllim propozoj krijimin e grupit punues. Propozoj z. Fatmir Xhelili, Goran Marinković, Vjollca Krasniqi dhe Emin Gerbeshi. Konsideroj se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim mund të kalojë me vërejtjet që mund ti kemi.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-099 për letërnjoftim, me këtë përbërje: Fatmir Xhelili-raportues, Vjollca Krasniqi, Emin Gerbeshi dhe Goran Marinković, anëtarë.

Secili anëtarë i Komisionit mund ti bashkëngjitet Grupit punues gjatë punës së tij, gjithashtu Grupi punues bashkë me Njësinë koordinuese të Komisionit të hartoi Planin e Veprimit dhe pastaj të përgatis raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Pyeti të pranishmit nëse kanë çështje për të ngritur në këtë pikë të rendit të ditës?

Fatmir Xhelili- Konsideroj se jemi vonuar në mbikëqyrjen e dy Ligjeve që kemi marrë në mbikëqyrje. Grupi punues që udhëhiqet nga ana ime është për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë. Për këtë gjë kemi pritur mbështetjen nga një këshilltar i OSCE-së me një takim udhëzues, por deri sa të ofrohet kjo mbështetje mendoj të fillojmë me këtë mbikëqyrje financiare të institucioneve të sigurisë. Propozoj që të kemi takim me auditorët e brendshëm të Kuvendit të Kosovës për të marrë udhëzime për një plan të veprimit në këtë sferë.

Kryetari i Komisionit- Mbështes këtë bashkëpunim, dhe në koordinim me administratën e Komisionit të realizohet një takim me Auditorin e brendshëm të Kuvendit të Kosovës, për të bërë mbikëqyrjen ndaj këtyre institucioneve.

Fatmir Xhelili- Grupi tjetër punues është për mbikëqyrje të Inspektoratit Policor të Kosovës. Gjithashtu edhe me këtë grup punues nuk kemi ecur sa duhet në rolin e mbikëqyrjes financiare.

Kryetari i Komisionit- Për të kryer këtë funksion duhet të jetë një angazhim më i madh, pasi mbikëqyrja demokratike e institucioneve që ka kompetencë Komisioni duhet të jetë funksionale. Për realizimin e këtyre takimeve në koordinim me administratën e Komisionit vendosen datat e mundshme.

Gjithashtu ju njoftoj për vizitën studimore në Austri, mbështetur nga DCAF-i, e cila është paraparë nga 17-21 shtator, 2012 por duke ditur se në këtë periudhë do të ketë një përshpejtim të ligjeve për përfundimin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, kërkohet një angazhim më i madh nga të gjithë anëtarët. Për këtë arsyeje mund të bëjmë ndonjë ndryshim për të koordinuar angazhimin e anëtarëve të Komisionit dhe të organizatorëve.

Luanda Domi, Zyrtare e projektit, DCAF- Data për vizitën studimore në Austri është caktuar afërsisht 17-21 shtator, 2012 në bashkëpunim me organizatorët dhe Komisionin e Mbrojtjes të Austrisë, kemi rënë dakord që në rast të ndryshimeve eventuale të datës për këtë vizitë për arsyeje të angazhimeve dhe zhvillimeve në Kuvendin e Kosovës, duhet të bëhet sa më shpejt, pasi më vonë nuk është e mundur.

Rexhep Selimi- Propozoj që të ketë një zhvendosje të datave, që nisja të bëhet me 16 shtator dhe kthimi me 20 shtator, për të pasur mundësi me qenë prezent në seancën e Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Planifikimi duhet të bëhet gjithashtu edhe në koordinim me Grupet Parlamentare të partive politike, në mënyrë që agjenda e planifikuar nga organizatorët për këtë vizitë studimore të realizohet.

Rexhep Selimi- Në funksion të organizimit më të mirë duhet të dihet agjenda e Kuvendit për seancat e radhës, duke qenë se do të ketë një sërë ligjesh që do të miratohen në përfundim të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Agjenda paraprake e Kuvendit për seancat plenare nuk dihet, pasi Kryesia e Kuvendit vendos edhe për seancat e jashtëzakonshme, por ne si Komision duhet të marrim vendim për këtë vizitë studimore.

Rexhep Selimi- Mbështes agjendën e propozuar nga organizatorët, në mënyrë që të realizohet programi i paraparë për këtë vizitë, përderisa nuk e dimë agjendën e Kuvendit për muajin shtator.

Kryetari i Komisionit- Për këtë vizitë studimore, propozoj që nisja të bëhet me datën 16 shtator 2012 dhe me 20 shtator 2012 të bëhet kthimi, nëse ekziston mundësia për një zhvendosje të datave për të qenë sa më funksional, në të kundërtën mbeten datat e propozuara nga organizatorët.

Goran Marinković- Për arsye se kam qenë në udhëtim zyrtar nuk kam mundur të jem i pranishëm në takimin e grupit punues në të cilin jam anëtar, në Inspektoratin Policor të Kosovës, për këtë arsye kërkoj mirëkuptim dhe se në të ardhmen do të kontribuoj pozitivisht.

Kryetari i Komisionit- Është mirë që anëtarët e grupeve punuese të jenë më të angazhuar në mënyrë që të dihet puna e Agjencive dhe institucioneve që mbikëqyren nga Komisioni.

Rexhep Selimi- Për zhvillimet e fundit në Policinë e Kosovës, mendoj që Komisioni mund ta thërras Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë të raportoj në Komision lidhur me vjedhjet që kanë ndodhur në Dhomën e Dëshmisë në Pejë dhe deri ku kanë shkuar hetimet për vjedhjet në dhomën e dëshmimeve në Prishtinë që ka ndodhur më herët. Komisioni si në funksionin e mbikëqyrjes së strukturës së policisë, duhet ta thërrasim ose vizitojmë këtë institucion, duke qenë se kjo është shqetësim i të gjithë qytetarëve, për këtë arsye në një nga mbledhjet e radhës së Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë mund të ftohet në Komision për të raportuar.

Kryetari i Komisionit- Për këtë çështje ka pasur prononcime edhe në media, si Komision kemi vërejtjet tona për ngjarjet e zhvilluara në Policinë e Kosovës. Këtë temë nuk e kam hapur qëllimisht pasi vlerësoj që është më mirë të priten zhvillimet e hetuesisë, Policisë së Kosovës, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, pas veprimeve të tyre nëse ne vlerësojmë që nuk kanë ndërmarrë veprimet e duhura në raport me ngjarjet që kanë ndodhur, kemi arsye më shumë për ti ftuar të raportojnë në Komision. Nëse pajtoheni në një takim të radhës së Komisionit vendosim se kur ti ftojmë për raportim në Komision Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë apo Ministrin e Punëve të Brendshme, por nuk duhet të ngutemi në këtë, pasi organet që janë kompetente duhet të veprojnë, në të kundërtën Komisioni ka obligim ti ftoj për raportim për këtë çështje.

Rexhep Selimi- Arsyeja për një raportim të tillë vlerësoj që duhet të bëhet pasi bazuar në raportin që është deklaruar që ekziston mes organeve të gjyqësorisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, kjo është prononcuar edhe nga Ministri i

Ministrisë së Punëve të Brendshme, i cili nuk është i kënaqur me punën e gjyqjesisë. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së do duhet të ishte i informuar për këto raporte mes këtyre institucioneve por edhe me “dukurinë” në Policinë e Kosovës.

Fatmir Xhelili- Pajtohem me z. Rexhep Selimi, pasi mos sqarimi i kompetencave mes Inspektoratit Policor të Kosovës dhe hetuesisë së Policisë së Kosovës nën kompetencat e Prokurorisë, duket që diçka nuk është në rregull në ndarjen e kompetencave bazuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës. Propozoj që përveç Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për raportim në Komision, të ftohet edhe Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës, pasi nga ajo që është thënë se kinse Inspektorati Policor i Kosovës nuk ka pasur mundësi të bëjë intervista me zyrtarët policor, për shkak të mos ingerencave të dhëna nga Prokurori, në mënyrë që Komisioni të lehtësoj dhe mbështes Inspektoratin Policor të Kosovës në marrjen kompetencave.

Kryetari i Komisionit- Propozoj që për të pasur një pasqyrë më të mirë të ngjarjeve të kërkojmë një raport paraprakisht dhe në bazë të tij më pas të bëhet vlerësimi dhe më pas të ftohen në Komision për të raportuar Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe Kryeshefin e Inspektoratit Policor të Kosovës.

Rexhep Selimi- Pajtohem me propozimin e z. Fatmir Xhelil që në Komision për raportim të ftohet edhe Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës për shkak të mos përmbushjes së kompetencave reciproke mes IPK-së dhe Policisë së Kosovës në zhvillimet e fundit.

Kryetari i Komisionit- Pajtohem që të kërkojmë raportin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga Inspektorati Policor i Kosovës, që deri në datën 15 qershor 2012 të kemi raportin dhe në bazë të tij vlerësojmë që në javën vijuese të ftojme në Komision Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe Kryeshefin e IPK-së. A jeni dakord me këtë propozim?

Në këtë pikë të rendit të ditës Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Kërkohet raport nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe raport nga Kryeshefi i Inspektoratit Policor të Kosovës për ngjarjen e ndodhur në Policinë e Kosovës me vjedhjen në dhomën e dëshmive në Pejë, që brenda datës 15 qershor 2012 të sjellin raportin e kërkuar.

Rasim Demiri- Krahas këtyre zhvillimeve, në qytetin e Prizrenit gjatë procedurës së zhvillimit të provimit për patentë shofer janë vërejtur parregullsi, pasi për të kaluar këtë

provim qytetarët kanë paguar një shumë të hollash, për ta kaluar atë. Gjithashtu edhe në testin e vozitjes ata kanë paguar shumën prej 50 euro, për këtë arsye Komisioni duhet të dijë se kush është kompetent për këtë gjë dhe të ngrejë si çështje shqetësuese, në mënyrë që të ndërmerren veprimet adekuate ndaj kësaj dukurie negative.

Kryetari i Komisionit- Kjo çështje është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës, këtë çështje mund ta diskutojmë edhe në seancë parlamentare, duke u deklaruar jashtë rendit të ditës dhe duke bërë pyetje parlamentare, pasi nuk është kompetencë e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së.

Rexhep Selimi- Raportimi për rastet e korrupsionit duhet bëhet në Prokurori edhe nga vet qytetarët, pastaj procedurat e tjera parandaluese, prandaj sugjeroj që z. Rasim Demiri këtë çështje ta procedoni në Prokurori duke qenë se jeni në dijeni të kësaj shkelje dhe akti korruptiv.

Kryetari i Komisionit- Në kuadër të aktivitetit të Komisionit kam një propozim që brenda kësaj jave në koordinim me FSK-në, të presim në Komision Komandantin e FSK-së, z. Kadri Kastari me bashkëpunëtorët e tij. Nga ky takim të kemi edhe një raport nga ana e tyre pasi tani është faza kur bëhet vlerësimi objektivave të FSK-së, në vjeshtë të 2012.

Propozimi i dhënë nga Kryetari u mbështet nga anëtarët e Komisionit.

Nëse nuk keni për të shtuar, me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi